

NGJITËS & RRAFSHUES



STIROBOND

Ngjyra	Paketimi	Konsumi si ngjitës
E bardhë, Gri	25 KG	3-5kg/m ²

PËRSHKRIM

Ngjitës për pllaka izolimi termik, EPS, për fasadë dhe xokolaturë. Gëzon aftësi shumë të mira në punim dhe rezistencë të lartë kundra lagështirës. Trashësia maksimale e shtresës deri në 30 mm.

FUSHA E APLIKIMIT

Për ngjitjen e të gjitha tipeve të pllakave për sistemin e izolimit termik për veshje fasadash dhe xokolaturash mbi mure tulle, bazamente me suva dhe beton.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhur, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Për bazamente që nuk janë të qëndrueshëm është e domosdoshme vendosja e kujnave fiksuese. Koha e puneshmërisë së përzierjes është 2-3 orë, në kushte normale temperaturash (20° C).

APLIKIMI

Përzieni me një përzierës elektrik 6-6.5 litra ujë me një thes 25 kg Stirobond në një enë të pastër, deri sa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Aplikoni produktin me mallë mbi pllakën izoluese në një trashësi prej 30 mm duke zënë rreth 45% të pllakes me ngjites me metoden me topa dhe shirita. Për aplikime në sipërfaqe të drejta është e këshillueshme që ngjitësi të hapet në të gjithë sipërfaqen e panelit dhe e suportit me ane të një malle të dhëmbëzuar (nga 8 deri 10 mm). Përpara nivelimit të sipërfaqes me kollë vendosni kunjat fiksuese në varësi të pllakës së vendosur 5-6 kunjat/m². Temperaturat optimale të punimit janë nga 50 C deri në 350 C. Për veshjet e mëvonshme është e rëndësishme që bazamenti të ketë arritur maturimin në tharje rreth 5-7 ditë kjo varet nga kushtet atmosferike.

KUJDES !

Aplikimi mbi mur tulle

- Duhet të sigurohemi që tullat duhet të jenë të ngjitura mirë dhe të mos kenë pjesë që mund të shpëputen. Nëse ka pjesë të paqendrueshme, ato duhet të rregullohen me llac.

Aplikimi mbi mur me tulla silicate dhe sipërfaqe të pluhurosura

- Sipërfaqet me pluhur duhen trajtuar me Astar Akrilik I holluar me ujë 1:2




Aplikimi në suporte të lemuara

- Keto sipërfaqe duhet të trajtohen fillimisht me beton kontakt



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Ujë për përzierjen: 6-6.5 litra ujë për 25 kg
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350kg	pH i perzierjes: >12
Ngjyra: E bardhë, Gri	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Kokrrizimi: 0.7 mm	Koef i konduktivitetit termik (λ 10,dry): 0.45 W/mK
Konsumi si ngjitës: 4-5 kg/m ²	Forca ngjitëse ne beton pas 28 ditësh: 1.2N/mm2
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Forca ngjitëse në EPS: 104.8 kPa
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Rezistenca ne shtypje: 11.1N/mm2
Masa Vëllimore: 1.6-1.7 gr/cm ³	Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1



KUJDESI! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalësim ose përsheptim në tharje të produktit). Mos e përdorni në:

- Suporte druri, metali, PVC apo sipërfaqe të tjera jo me bazë çimento.
- Në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme.
- Suporte që karakterizohen nga vibrime të përqëndrueshme.
- Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë.